

VENDIM
Nr. 6, datë 26.3.2012

PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË “UJËSJELLËS HIMARË” SHA

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë ...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencohet për herë të parë operatori “Ujësjellës Himarë” sh.a. me:
Drejtues ligjor: z. Athanasio Ruçi
Drejtues teknik: znj. Leonora Dupi
2. Operatori “Ujësjellës Himarë” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Himarë, fshatrat: Himarë, Qeparo, Livadh, Vuno, Dhërmi, Palasa, Piluri.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 26.3.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi